

Normandia e Poshtme Maqedonia, bashkëpunimi në shërbim të qeverisjes lokale

BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE

Bashkëpunimi i decentralizuar mes Rajonit të Normandisë së Poshtme dhe Maqedonisë është produkt i vullnetit të përbashkët për të marrë pjesë në zhvillimin paralel të dy territoreve, duke u hapur për botën dhe dëshira që popujt e tyre të angazhohen në qytetari aktive lokale dhe evropiane, në frymën e reciprocitetit dhe shkëmbimit. Projekti do të shpie drejt krijimit të një platforme konstante të shkëmbimeve dhe do të mundësojë themelimin e lidhjeve të qëndrueshme mes popullatave të dy territoreve evropiane dhe anëtare të frankonisë.

Në këtë drejtim, më 20 shkurt 2007 ishte firmosur një **protokoll për bashkëpunim** midis Presidentit të Rajonit të Normandisë së Poshtme dhe ambasadorit të Maqedonia-së në Francë. [Shkarkoni protokollin në format .pdf](http://www.region-basse-normandie.fr/documents/europe/protocole_BN-macedoine.pdf) [http://www.region-basse-normandie.fr/documents/europe/protocole_BN-macedoine.pdf] [fr].

Programi i vazhdueshëm për bashkëpunim ishte e elaboruar mes aktorëve normand dhe maqedonas (nëntor 2007-nëntor 2010). Për shërbim të pushtetit lokal, ajo ndahet në **6 shtylla**:

1. Përdorimi i teknologjive të informimit dhe komunikimit (TIK)
2. Rini, arsim, qytetari lokale dhe evropiane
3. Shoqëri për informim dhe media
4. Shkëmbime kulturore dhe artistike
5. Turizmi i qëndrueshëm dhe trashëgimia
6. Partneritete në mes pushteteve lokale.

Shoqata e Agjencive për Demokraci Lokale (ALDA) është përgjegjëse për koordinimin e këtij programi për bashkëpunim.